



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/45
Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 44 dhe 45 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/45
Datë: 14.11.2008


Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Agjencionit Kosovar të Privatizimit (239) i lejohet transferimi i mjeteve financiare në shumën prej 325,000 (treqind e njëzetepesëmijë) Euro.
2. Transferet bëhen nga Departamenti i Likuidimit (227) në shumën 100,000 (njëqindmijë) Euro dhe nga Departamenti i Privatizimit në shumën prej 225,000 (dyqind e njëzetepesëmijë) Euro në kodin buxhetor (229) të Administratës Qendrore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/45
Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 125.000 (njëqind e njëzetepesë mijë) Euro për sigurimin e ngrohjes dhe ushqimit.
2. Mjetet financiare sipas pikës një të këtij vendimi sigurohen nga kodi 003 i transfereve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe transferohen në xhirollogari të Shoqatës me numër : 1110-003683-001-63.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/45

Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Autorizohet Ministria e Shërbimeve Publike që nga automjetet të cilat janë paraparë të procedohen në ankand publik, të bëjë përzgjedhjen e automjeteve të cilat janë në gjendje të mirë teknike, të cilat do t'iu shpërndahen sipas nevojës Institucioneve të Republikës së Kosovës
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
3. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/45
Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori


V E N D I M

1. Qeveria i propozon Kuvendit të Kosovës, miratimin e marrëveshjes vijuese të përkohshme për funksionim të duhur dhe efektiv të KELP-it, deri në pritje të finalizimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjeve të Kuvendit të Kosovës që do të rregullojnë Shërbimin Civil të Kosovës duke përfshirë edhe emërimin e zyrtarëve të lartë.
2. Komisioni për Emërime të Larta Publike (KELP) do të përbëhet nga Kryeministri, i cili do të jetë Kryesues, dhe anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Ministri i Shërbimeve Publike
 - b) Dy Ministra nga komunitetet jo-shqiptare të Kosovës.
 - c) Ministri, për të cilin kandidati për emërim do të shërbej si anëtar ad hoc.
 - d) Gjashtë banorë eminent të Kosovës apo me kualifikim të përafërt që vijnë nga shoqëria civile Kosovare.
3. Kryeministri dhe ministrat e Qeverisë do të shërbejnë si anëtarë ex-officio. Gjashtë anëtarët sipas pikës 2. (d) të këtij vendimi, do të propozohen nga Kryeministri pas konsultimeve të duhura, dhe do të emërohen nga Presidenti i Kosovës për një mandat një vjeçar, i cili mund të mbaroj më herët nëse hyn në fuqi legjislacioni relevant i Kuvendit.
4. Marrëveshjet e përkohshme do të zëvendësojnë marrëveshjet e ekspozuara në legjislacionin e tanishëm në fuqi dhe do të aplikohet për aq kohë sa të miratohet dhe të hyjë në fuqi legjislacioni i ri nga Kuvendi i Kosovës.

5. Qeveria e Kosovës ia dorëzon këtë propozim Kryetarit të Kuvendit të Kosovës për konsideratë dhe aprovim nga Kuvendi përmes një procedure të shpejtë që t'i mundësojë Komisionit për Emërime të Larta Publike të zbatoj përgjegjësitë e veta të rëndësishme pa u vonuar.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/45

Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori


V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË QEVERISË NR. 07/29 DATË 31.07.2008

1. Anullohet paragrafi 4 i vendimit të Qeverisë Nr. 07/29 i datës 31.07.2008, lidhur me kufizimin e shtesave.
2. Pagesa shtesë duhet të bëhet sipas Aneksit 1 të vendimit të Qeverisë Nr. 02/39 datë 08/10/2008.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/45
Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Projekt-Strategjisë Legjislative për vitin 2009 në këtë përbërje:
 - a) Zëvendëskryeministri Ramë Manaj – Kryesues
 - b) Këshilltar i zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi – anëtar
 - c) Drejtori i Zyrës për Shërbimet e Ndihmës Juridike – ZKM – anëtar
 - d) Përfaqësues nga Departamenti Ligjor – Ministria e Drejtësisë – anëtar
 - e) Përfaqësues nga Departamenti për Buxhet dhe Financa – Ministria e Ekonomisë dhe Financave – anëtar
 - f) Përfaqësues nga Agjencioni për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrimi Evropian – ZKM – anëtar
 - g) Përfaqësues nga Ambasada Amerikane – vëzhgues
 - h) Përfaqësues nga Zyra Ndërkombëtare Civile - ICO – vëzhgues
2. Grupi Punues nën kryesimin e Zëvendëskryeministrit Ramë Manaj, obligohet ta përgatis Projekt-Strategjinë Legjislative për vitin 2009.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/45

Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave që në Strategjinë Legjislative për vitin 2008 të përfshihet edhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbime dhe Ndhimë Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/45

Datë: 14.11.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Produktet Biocide.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika një e këtij vendimi t’ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë